



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada - Government**

**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Kancelariaj Ministra Pravde - Cabinet of the Minister of Justice

Nr. 129/2024  
Datë: 15/05/2024

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2), nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (GZ Nr. 7, 01 mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministrija e Drejtësisë, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Emërohet Grupi Punues për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-188 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, në këtë përbërje:

- 1.1. Blerim Sallahu, Zëvendësministër, Kryesues;
- 1.2. Feride Podvorica, DL, Zv. Kryesuese;
- 1.3. Nazlie Bala, Këshilltare e Ministres, anëtare;
- 1.4. Eros Gashi, Këshilltar i Ministres, anëtar;
- 1.5. Alberita Hyseni, ZL/ZKM, anëtare;
- 1.6. Besim Kelmendi, U.D. Kryeprokuror i Shtetit, anëtar;
- 1.7. Përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, anëtar/e;
- 1.8. Përfaqësues nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, anëtar/e;
- 1.9. Përfaqësues nga MPB, anëtar/e;
- 1.10. Përfaqësues nga Policia e Kosovës, anëtar/e;
- 1.11. Përfaqësues nga Dogana e Kosovës, anëtar/e;
- 1.12. Përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë, anëtar/e;
- 1.13. Emine Abdyli, Universiteti i Prishtinës, anëtare;
- 1.14. Valmira Maxhuni Uka, DL/MD, anëtare;
- 1.15. Arlinda Alshiqi, DL/MD, anëtare;
- 1.16. Nexhat Syla, DBF/MD, anëtar;
- 1.17. Përfaqësues nga Oda e Avokatëve të Kosovës, anëtar/e;
- 1.18. Përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar/e.

2. Pjesë e Grupit Punues ftohen edhe përfaqësuesi/ja nga:

2.1. Ambasada Amerikane në Kosovë;

2.2. Zyra e BE-së në Kosovë.

3. Gjatë hartimit të Projektligjit, Grupi Punues duhet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të parashikuara në Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Kosovës dhe legjislacionit përkatës në fuqi për hartimin e legjislacionit.

4. Sipas nevojave të Grupit Punues për realizimin e obligimeve të parapara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe përfaqësues të tjerë nga institucionet publike dhe shoqëria civile.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Abdulla HAXHIU  
Ministre e Drejtësisë

Vendimi i'u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Kabinetit të Ministres së Drejtësisë;
- Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.